



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2018

Lënda: Dërgohet formulari i njoftimit të fituesit (Kopje e përmbledhur e cila do të publikohet në buletin)

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
Pranë Këshillit të Ministrave, Tiranë**

Autoriteti Kontraktor: Adresa, nr. tel: Bashkia Shkodër L. "Vasil Shanto", Rr. "13 Dhjetori", tel +35522400150.

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e Hapur (prokurim publik me mjete elektronike).

Objekti i prokurimit (nqs ka lotë i ndarë sipas lotëve): **"Rikualifikim Urban Blloqe Banimi "Qemal Draçini" (tek Sahati)".**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-83696-08-23-2018**

Fondi limit (nqs ka lotë i ndarë sipas lotëve): **23 800 080** (Njëzet e tremilion e teteqindmije e tetedhjetë) leke pa tvsh.

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë.

Vlera e shpallur fituese (nqs ka lotë e ndarë sipas loteve): **18,897,168.72** lekë pa tvsh.

Data e zhvillimit të tenderit: data 24.09.2018, ora 10.00. vendi: Njesia e Prokurimeve Publike Bashkia Shkodër.

Operatori/et ekonomik i/të shpallur fitues: **"Rroku GUEST sh.p.k** NUIS K 87921701 H & **"Shpresa – Al" sh.p.k.** NUIS K 31321021 N perfaqesuar me prokure te posacme nga **"Rroku GUEST sh.p.k.** Adresa: Rruga Nazmi Kryeziu-Shkoder

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
VOLTANA ADEMI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMEVE**

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Ref. **2141-001**

Data 06 / 11 / 2018

Nga: Bashkia Shkodër. Adresa: L. "Vasil Shanto", Rr. "13 Dhjetori", Tel & Fax +35522400150.

Për: "Rroku GUEST sh.p.k NUIS K 87921701 H & "Shpresa – Al" sh.p.k. NUIS K 31321021

N perfaqesuar me prokure te posacme nga "Rroku GUEST sh.p.k. Adresa: Rruga Nazmi Kryeziu-Shkoder

-Procedura e prokurimit: Procedure e Hapur .

-Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-83696-08-23-2018**

-Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Rikualifikim Urban Blloqe Banimi "Qemal Draçini" (tek Sahati)".

Fondi limit (nqs ka lotë i ndarë sipas lotëve): **23 800 080** (Njezet e tremilion e teteqindmije e tetedhjete) leke pa tvsh

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkise.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

-Afati i përfundimit të punimeve: 4(kater)muaj.

-Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike datë 27.09.2018 nr.34.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 24.09.2018, ora 10.00.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë keta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1-Bashkimi i operatoreve ekonomik "Karl Gega Konstruksion sh.p.k NUIS J 66703076 W & "Albavia" sh.p.k NUIS J 81527001 Q perfaqesuar me prokure te posacme nga operatori ekonomik "Karl Gega Konstruksion" sh.p.k me administrator z.Hartjan Sallaku.

Vlera **16,123,191** leke pa tvsh (Gjashtembedhjetemilion e njeqind e njezet e tremije e njeqind e nentedhjete e nje leke)

2-Bashkimi i operatoreve ekonomik "S.M.O. Vataksi" sh.p.k NUIS L 47022001 J& "S.M.O. Union" sh.p.k NUIS J 66902042 Q perfaqesuar me prokure te posacme operatori ekonomik "S.M.O. Vataksi" sh.p.k me administrator z.Xhevat Vataksi.

Vlera **17,100,636** leke pa tvsh (Shtatembedhjetemilion e njeqindmije e gjashteqind e tridhjete e

gjashte leke)

3.Operatori ekonomik“Varaku-E” sh.p.k. me administrator z.Shpetim Varaku me NUIS J61902509S

Vlera **17,707,251** leke pa tvsh (Shtatembedhjetemilion e shtateqind e shtatemije e dyqind e pesedhjetë e një leke)

4-Operatori ekonomik “B 93” sh.p.k me administrator z.Shpetim Licaj perfaqesuar me prokure te pergjithshme nga z.Dashnor Liçaj. NUIS J 62903508 R

Vlera **18,209,989** leke pa tvsh (Tetembedhjetemilion e dyqind e nentemije e nenteqind e tetedhjetë e nente leke)

5-Bashkimi i operatoreve ekonomik Rroku GUEST sh.p.k NUIS K 87921701 H &“Shpresa – AI” sh.p.k. NUIS K 31321021 N perfaqesuar me prokure te posacme nga operatori ekonomik “Rroku GUEST sh.p.k me administrator z.Rrok Gega

Vlera **18,897,168.72** leke pa tvsh (Tetembedhjetemilion e teteqind e nentedhjetë e shtatemije e njeqind e gjashtedhjetë e tete pike shtatedhjetë e dy leke)

6.Operatori ekonomik “Shkelqimi 07” sh.p.k. me administrator z.Shkëlqim Kapllanaj me NUIS K 68121808 W

Vlera **20,000,000** leke pa tvsh (Njezet milion leke)

Ka ofertues te skualifikuar.

1-U skualifikua bashkimi i operatoreve ekonomik “Karl Gega Konstruksion sh.p.k & “Albavia”sh.p.k per keto arsye:

-Nuk keni paraqitur analizat e cmimeve ne rruge elektronike dhe shkresore sipas kerkeses se bere nga KVO nr.16857 prot date 11.10.2018

2-U skualifikua bashkimi i operatoreve ekonomik”S.M.O. Vataksi” sh.p.k & “S.M.O. Union”sh.p.k per keto arsye:

-Bazuar ne vertetimin date 19.09.2018 (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqerore e Shendetësore per Tatimpaguesin - E-SIG 02/a) Nr. T00562441 rezulton se subjekti S.M.O Vataksi sh.p.k ka 321,550 leke detyrime te papaguara.

-Mungon deklarata nga administratori i shoqerise per te dy anetaret e bashkimit te shoqerive,sipas pikes 2.3.3 kapaciteti teknik I DST, Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

-Nuk plotesoni piken 2.3.5 kapaciteti teknik I DST qe operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar te pakten 1(nje)inxhinier mjedisi(i pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis) pasi ing.J.Fejzullahu,Ing.D.Duka qe jane

inxhinierë mjedisi nuk janë të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ndërsa ing.A.Vucini është i diplomuar në fakultetin e inxhinierisë mekanike dhe jo në inxhinierinë e mjedisit.

- Deshmitë për teknike ndërtimi paraqitur nga shoqëria Shoqëria Vataksi sh.p.k janë thjesht për teknike por nuk specifikohet se çfarë teknikesh janë.

-Nuk është deklaruar kontrata me Bashkinë Malesi e Madhe „Riparime me asfaltim rrugë rurale”

-Operatori ekonomik B -93 shpk, në lidhje me deshmitë për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për kapacitetin teknik “Autobitumatriçe”, në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur kontratën e qerases me subjektin Elva 2001 shpk, me afat përdorimi pa afat të përcaktuar . Po ky mjet me targë AA830LT, është paraqitur dhe nga shoqëria SMO Vataksi sh.p.k në po këtë procedurë prokurimi, për një periudhë kohore një vjeçare, ose që përfshin këtë periudhë, çfarë e bën këtë kontratë fiktive dhe të pavlefshme.

3-U skualifikua operatori ekonomik “ Varaku-E” sh.p.k.për keto arsye:

-Operatori ekonomik “Varaku E” shpk nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm” pasi për mjekun e përgjithshëm, Urdhëri i Mjekut, Nr. 27 (leje individuale për për ushtrimin e profesionit për mjekë) rezulton i pavlefshëm. (lëshuar në datë 09.04.2012 dhe leja është e vlefshme për 5 vjet dhe rinovimi bëhet 2 muaj përpara mbarimit të afatit). Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se Operatori ekonomik “Varaku E” shpk nuk ka paraqitur dokumentin e rinovuar

-Zj.Greta Varaku e paraqitur si Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë është me profesion ekonomiste dhe nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë për periudhën janar-gusht 2018.

4-U skualifikua operatori ekonomik “ B 93” sh.p.k. për keto arsye:

Operatori ekonomik B -93 shpk, në lidhje me deshmitë për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për kapacitetin teknik “Autobitumatriçe”, në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur kontratën e qerases me subjektin Elva 2001 shpk, me afat përdorimi pa afat të përcaktuar . Po ky mjet me targë AA830LT, është paraqitur dhe nga shoqëria SMO Vataksi sh.p.k në po këtë procedurë prokurimi, për një periudhë kohore një vjeçare, ose që përfshin këtë periudhë, çfarë e bën këtë kontratë fiktive dhe të pavlefshme.

-Ing. I mjedisit Florian Hoxhaj I pajisur me certificate për ndikimin në mjedis nuk figuron në

listepagesat e shoqerise per priudhen janar – prill

-Kamionit me targa AA913 DE I mungon taksa e qarkullimit

-Asnje nga hidrauliket e paraqitur nuk figuron ne listepagesat e shoqerise per periudhen janar-gusht 2018

-Kamionit me targa AA601 NP I mungon fotoja per identifikimin e mjetit

-Per te gjitha mjetet e marra me qera nga z.Laver Shytia si me poshte mungon fotoja per identifikim:

Lloji-Kamion me targe AA651 DY; 2. Lloji Kamion me targe AA978AM; 3. Fadrome me goma me targe AGMT02; 4. Eskavator me zinxhir.

5-U skualifikua operatori ekonomik “Shkelqimi 07” sh.p.k. per keto arsye:

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin Autobitumatriçe, me targë AA 617OA, të deklaruar nga operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk konstatoi se mjeti rezulton te jete i montuar kamion i certifikuar per transport mallrash brenda vendit + cisterne bitumi, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15

Nuk ka paraqitur dokumentacionin per mjetin fadrome me goma si leje qarkullimi ,aktkolaudimi etj.

Nuk eshte deklaruar kontrata me Bashkine Memaliaj “Riparimi i rruges nga rruga nacionale – qender fshat Vasjar, rruga Kthesa e Çerriles, rruga nacionale – qender Fshat Memaliaj

Nuk ka paraqitur deklarate mbi disponiomin e fuqise punetore

Ankesa.Ka patur.

Me shkresën nr.174829 prot datë 22.10.2018 protokolluar pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër ka paraqitur formularin e ankesës për prokurimin në lidhje me vendimin e KVO operatori ekonomik “ **Varaku E**“ **sh.p.k**

Me shkresen nr. 174829 prot datë 26.10.2018 iu kthye pergjigje operatorit ekonomik “ **Varaku E**“ **sh.p.k** duke mos marre ne konsiderate pretendimet e tij dhe duke e refuzuar ate.

Eshte respektuar afati 10 ditor i ankimimit prane KPP.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**Rroku GUEST sh.p.k** NUIS K 87921701 H & “**Shpresa – AI**” **sh.p.k.** NUIS K 31321021 N perfaqesuar me prokure te posacme nga operatori ekonomik “**Rroku GUEST sh.p.k** me administrator z.Rrok Gega.Adresa: Rruga Nazmi Kryeziu-Shkoder, se oferta e paraqitur me nje vlere te pergjithshme prej **18,897,168.72** leke pa tvsh (Tetembdhjetemilion e teteqind e nentedhjte e shtatemije e njeqind e gjashtedhjte e tete pike shtatedhjte e dy leke) është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Njesise se Prokurimeve Publike,Bashkia Shkodër, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) diteve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.Gjithashtu duhet te paraqitni te gjithe dokumentacionin e

hedhur ne tender origjinal ose kopje te noterizuar, te numerizuar dhe te inventarizuar.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) /, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në date 16.10.2018.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
VOLTANA ADEMI

